



Planuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivry	09.06.2023	3	viti god
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KRM/SHCK	4656/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.709/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.709/2023 të datës 05.05.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë: Nr.1, Komuna e Prizrenit, kundër Vendimit KD.Nr.016/2023 të datës 03.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 09.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër KD.nr.16/2023 i datës 03.04.2023 i Komisionit Disiplinor në Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- II. OBLIGOHET Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të bëjë rishqyrtimin e lëndës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit
- III.OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, t'i ndërmer të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij Vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit *[Emri i ankuesit]* i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Kontratës së Punës KI, 1008075561 të datës 02.07.2018 në pozitën e punës “Mbikëqyrës” në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, më datë 20.03.2023 Zëvendës Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Prizren ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit Nr.2320/23 për iniciimin e procedurës disiplinore. Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 03.04.2023, ka nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.16/2023, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “*ndalim 20% e pagesës për periudhën dy (2) muaj*”.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër KD.nr.16/2023 të datës 03.04.2023 të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4069/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 05.05.2023, me pretendimin ankimor se ankuesi i takon komunitetit “*Boshnjak*” në Republikën e Kosovës dhe gjuhë amtare në komunikim, shkrim dhe lexim e ka gjuhën Boshnjake dhe i njëjti pak e kupton dhe e flet gjuhën shqipe lokaliste, pa e kuptuar terminologjin e fjalëve juridike, veçanrisht në rastin e zhvillimit të ndonjë procedure administrative siç është në rastin konkret të ankimit të këtij Vendimi. Andaj i njëjti kërkon që ti sigurohet përkthyes pa pagesë nga organi i cili ka zhvilluar procedurën disiplinore ndaj ankuesit si dhe Vendimi i atakuar ti dorëzohet edhe në gjuhën e përkthyer krahas origjinalit në gjuhë shqipe, për ta kuptuar kuptimin e tij në thelb. Gjithashtu sipas pretendimeve ankimore të ankuesit krahas pretendimeve të lartëcekura i njëjti ka theksuar se gjatë zhvillimit të procedurës nuk është këshilluar për të drejtat e tij nga Komisioni, ndër të tjerash për të drejtën e angazhimit të Avokatit me rastin e marrjes në pyetje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.05.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 05.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4069/2023 të datës 05.05.2023 të parashtruar nga përfaqësuesi me autorizim i ankuesit Av.N.M në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 03.05.2022; Vendim me numër KD.Nr.16/2023 i datës 03.04.2023 i Komisionit Disiplinor të SHKK-së; E gjetura me numër 72258 e datës 22.09.2018; Shërbime të laboratorit të datës 28.08.2018; Udhëzim me numër 079740; Raport nga konsulta mjekësore; Raport kthyes nga laboratorit i datës 28.08.2018; Raport Mjekësor; Raport Mjekësorë i datës 18.01.2020; Ekzaminimi i gjakut; Kërkesë për përgjegje në ankesë e datës 31.05.2023; Përgjigje në ankesë me numër të protokollit Nr.790 e datës 05.06.2023; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 02.07.2018; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore me numër të protokollit 0320/23 e datës 20.03.2023; Ftesë për intervistë për ankuesin M.B e datës 27.03.2023; Procesverbali i datës 30.03.2023; Fletëkthesë e datës 04.04.2023; Raport me numër protokollit Nr.0318/2023 i datës 20.03.2023; Informatë me numër Nr.344/23 e datës 18.03.2023 nga Mb.Xh.T; Deklaratë me numër Nr.349/23 e datës 19.03.2023 nga Mb.M.B; Informatë me numër



Nr.345/23 e datës 18.03.2022 nga D.K; Informatë me numër Nr.356/23 e datës 21.03.2022 nga O.k D.K; Informatë me numër 384/23 e datës 19.03.2023 nga Mb.i lartë O.H; Formulari i kontrollimit të çelsave i datës 18.03.2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 6 paragrafit 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në **rishqyrtim, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës ka konstatuar se, Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht me nenin 71 ku përcaktohet se *"1. Organi publik do të garantojë që procedura administrative të zhvillohet në gjuhën siç është parashikuar me ligjin për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës. 2. Palët kanë të drejtë të komunikojnë dhe njoftohen në gjuhën e tyre amtare, nëse ajo është një nga gjuhët e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. 3. Gjuha e procedurës administrative konkrete do të përcaktohet duke u bazuar në gjuhën e parashitësës së parë apo kërkesës të posaçme të palës, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni. 4. Organi publik që kryen procedurën, duhet të garantojë të drejtën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, pa asnjë kosto shtesë për palën. 5. Me përcaktimin e gjuhës së procedurës konkrete, sipas paragrafit 3 të këtij neni, asnjë veprim administrativ apo procedural nuk prodhon pasoja juridike ndaj palës, nëse është kryer në një gjuhë tjetër të ndryshme nga ajo e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni"*, si dhe Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve përkatësisht neni 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 si dhe nën paragrafi 4.5 ku përcaktohet se, *"4.1. Në institucionet qendrore të Kosovës zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare. 4.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga institucionet qendrore të Kosovës në cilëndo gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet qendrore kanë për detyrë të sigurojnë që çdo person mund të komunikojë dhe mund të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga organet dhe institucionet e tyre në cilëndo gjuhë zyrtare"*, 4.5. *Shënimet dhe dokumentet zyrtare do të mbahen dhe nxirren në gjuhët zyrtare.* Andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.16/2023 të datës 03.04.2023 me të cilin ankuesit Mehmed Bajrami i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalim 20% i pagës për periudhën dy (2) muaj"* ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura , mbi bazën e asaj që i njëjti gjatë mbajtjes së seancës disiplinore lidhur me rastin e ankuesit fillimisht nuk e ka trajtuar faktin se i njëjti i përket përkatësisë Boshnjake në atë mënyrë që zhvillimi i kësaj procedure të bëhet në gjuhën të cilën e kupton ankuesi çështje kjo parësore në këtë procedurë.

Andaj marrë parasysh faktin si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor bazuar ne arsyetimet e lartëcekura është i obliguar që me rastin e mbajtjes së seancës disiplinore ndaj ankuesit, fillimisht të njëjtën ta zhvilloj ne gjuhën në të cilën ankuesi e kupton si dhe ti sigurohet perkthyesi në menyrë që të jetë i informuar me zhvillimin e Procedurës Administrative ndaj tij dhe pas ndërmarrjes se ketyre veprimeve te merr Vendim meritor bazuar në Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 71 dhe

Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve nenin 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 si dhe nën paragrafi 4.5.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.709/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

